

# TRIBUNALI PENAL NDËRKOMBËTAR PËR ISH-JUGOSLLAVINË

Lënda Nr. IT-04-84-PT

## PROKURORJA E TRIBUNALIT

### KUNDËR

**Ramush HARADINAJT**  
**Idriz BALAJT**  
**Lahi BRAHIMAJT**

## AKTAKUZA E NDRYSHUAR PËR HERË TË KATËRT

Prokurorja e Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë, në bazë të kompetencave të saj sipas Nenit 18 të Statutit të Tribunalit Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë akuzon:

**Ramush Haradinajn**  
**Idriz Balajn**  
**Lahi Brahimajn**

Për **KRIME KUNDËR NJERËZIMIT** dhe **SHKELJE TË LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS**, si parashtrohen më poshtë.

### TË AKUZUARIT

1. **Ramush Haradinaj** (“gjithashtu i njohur si “Smajl”) u lind më 3 korrik 1968 në Gllogjan<sup>1</sup>, në komunën e Deçanit, në Kosovë, në ish-Jugosllavi.
2. Së paku nga 1 marsi 1998 deri në mes të qershorit 1998, **Ramush Haradinaj** ishte komandant *de facto* në *Ushtrinë Çlirimtare të*

---

<sup>1</sup> Në variantin anglisht të tëra fshatrat identifikohen me emrin në serbisht dhe shqip

*Kosovës* (UÇK), në anglisht Kosovo Liberation Army(KLA). Në mes të qershorit 1998, **Ramush Haradinaj** u emërua komandant *de jure*. Si komandant, **Ramush Haradinaj** kishte komandë të përgjithshme të forcave të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit që ndodhej në Kosovën perëndimore. Ai ishte ndër udhëheqësit më të lartë të UÇK-së në Kosovë.

3. Zona Operative e Dukagjinit përfshinte komunat e Pejës, Deçanit, Gjakovës, dhe pjesë të komunave të Istogut dhe të Klinës. Fshatrat Baran, Bellopojë, Kosuriq, Loxhë, Novosellë e Poshtme, Napolë, Pejë, Turjakë dhe Zahaq në komunën e Pejës; Baballoq, Dashinoc, Deçan, Gjocaj, Dubravë, Gllogjan, Gramaçel, Junik, Lloçan, Pozhare, Ratishë dhe Irzniq në komunën e Deçanit; Gjakovë, Dujakë, Jabllanicë, Piskotë, Plançar dhe Zhabël në komunën e Gjakovës; Dollc dhe Grabanicë në komunën e Klinës; dhe rrethina e kanalit të Liqenit të Radoniqit ishin brenda zonës së komandës dhe kontrollit të **Ramush Haradinajt**.
4. Në pranverë të vitit 1998, UÇK-ja kishte një Shtab të Përgjithshëm por asnjë komandant i lartë i identifikuar nuk jepte urdhra. Çdo zonë operative e UÇK-së në Kosovë vepronte në mënyrë të pavarur nga autoriteti më i lartë komandues. **Ramush Haradinaj** ishte një nga komandantët më të pavarur të zonave. Baza e tij për operacione ushtarake ishte oborri i tij familjar në Gllogjan, i cili u bë edhe selia e shtabit të UÇK-së për Zonën Operative të Dukagjinit.

5. Nga fillimi i prillit 1998, pjesë të Deçanit dhe Gjakovës rreth bazës së Gllogjanit të **Ramush Haradinaj** ishin padyshim nën kontrollin e tij dhe brenda fundit të qershorit 1998 ai e kishte zgjeruar kontrollin në komunat fqinje të Pejës, Istogut dhe Klinës. Si Komandant i Zonës Operative të Dukagjinit, **Ramush Haradinaj** kontrollonte njësitë vendëse të UÇK-së. Komandantët e nënzonave në zonë merrnin urdhra prej tij dhe i zbatonin. Veç pushtetit të tij ushtarak, në strukturën klanore të shoqërisë kosovare **Ramush Haradinaj** ishte figurë e spikatur në zonën e fshatit të tij të lindjes, Gllogjan dhe në komunën e Deçanit.
6. **Ramush Haradinaj** e mbajti pozitën e tij si Komandant i Zonës Operative të Dukagjinit gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë së paku deri në përfundimin e luftimeve në qershor 1999.
7. Në 1999, **Ramush Haradinaj** iu bashkua Trupave Mbrojtëse të Kosovës (TMK), një forcë e re e krijuar prej Misionit të Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) për t'i përfshirë njësitë e UÇK-së në strukturën e re të forcave, nën administrimin ndërkombëtar në Kosovë. Ai u bë Komandant i Grupit të Dytë Rajonal të TMK-së, me qendër në Prizren. Në vitin 2000 ai u tërhoq nga pozita e tij në TMK dhe themeloi partinë politike të quajtur "Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës" (AAK). Ai ishte anëtar i parlamentit nga 2001 deri në 2004. Në dhjetor 2004 ai u bë Kryeministër i Kosovës.

8. **Idriz Balaj (gjithashtu i njohur si “Togeri”)**, u lind më 23 gusht 1971 në Gllarevë të Komunës së Klinës në Kosovë, në ish-Jugosllavi.
9. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Idriz Balaj** ishte anëtar i UÇK-së. Ai komandonte një njësi speciale e njohur si “Shqiponjat e Zeza”. Me miratimin e **Ramush Haradinajt** njësia “Shqiponjat e Zeza” u krijua në prill 1998 si Njësi Speciale e Ndërhyrjes së Shpejtë. Kjo njësi zakonisht e kishte bazën në fshatin Irzniq, numri i forcave të saj ndryshonte nga 40 deri në 100 ushtarë dhe anëtarët e saj ishin prej fshatrave të ndryshme. **Ramush Haradinaj** e ndihmoi **Idriz Balajn** në stërvitjen e Shqiponjave të Zeza që vepronin anembanë komunave në Zonën Operative të Dukagjinit. Si Komandant i Shqiponjave të Zeza, **Idriz Balaj** ishte drejtpërsëdrejti i varur prej **Ramush Haradinajt** dhe bashkëpunonte ngushtë me të.
10. Në 1999, pas përfundimit të luftimeve, **Idriz Balaj** iu bashkua TMK-së dhe mbante rangun major.
11. **Lahi Brahimaj (gjithashtu i njohur si “Magjupi”)** u lind më 26 janar 1970 në Jabllanicë të komunës së Gjakovës në Kosovë, në ish-Jugosllavi. **Lahi Brahimaj** është dajë i **Ramush Haradinajt**.
12. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Lahi Brahimaj** ishte anëtar i UÇK-së me bazë në shtabin e Jabllanicës. Ai u emërua Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit më 23 qershor 1998. Ai mbeti Zëvendëskomandant deri më 5 korrik 1998 kur u hoq nga kjo detyrë. Pastaj vëllai i tij Nazmi Brahimaj e zëvendësoi atë

duke u emëruar Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit. Më tej **Lahi Brahimaj** shërbeu si Drejtor i Financës në Shtabin e Përgjiithshëm të UÇK-së. Gjatë tërë periudhës së aktakuzës, pavarësisht ndryshimit formal të funksionit, **Lahi Brahimaj** ishte vartës i **Ramush Haradinajt** dhe bashkëpunonte ngushtë me të. Pas ndalimit të luftimeve **Lahi Brahimaj** u bë oficer me rang të lartë në TMK.

## **AKUZAT E PËRGJITHSHME**

13. Të gjitha veprimet ose mosveprimet e akuzuara në këtë aktakuzë si krime kundër njerëzimit ose shkelje të ligjeve ose zakoneve të luftës ndodhën midis 1 marsit 1998 dhe 30 shtatorit 1998 në Kosovë, në ish-Jugosllavi.
14. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, në Kosovë ekzistonte gjendja e konfliktit të armatosur midis UÇK-së dhe forcave të Republikës Federale të Jugosllavisë dhe të Ministrisë së Brendshme të Republikës së Serbisë (Forcat Serbe). Krimet e akuzuara në këtë aktakuzë bazuar në Nenin 3 të Statutit të Tribunalit lidheshin ngushtë me konfliktin e armatosur. Viktimat e këtyre krimeve ishin persona të cilët nuk merrnin pjesë aktive në luftime. Viktimat ishin kryesisht civilë serbë, shqiptarë kosovarë, romë/egjiptianë kosovarë ose civilë të tjerë. UÇK-ja i konsideronte shumicën e këtyre viktimave civile si bashkëpunëtorë të Forcave Serbe, ose si mospërkrahës të UÇK-së, ose se i rezistonin UÇK-së me mjete joushtarake.
15. Të gjitha veprimet ose mosveprimet e akuzuara si krime kundër njerëzimit në këtë aktakuzë ishin pjesë e një sulmi të gjerë ose sistematik të UÇK-së drejtuar kundër pjesëve të popullatës civile në komunat e Deçanit, Pejës, Gjakovës, Istogut dhe Klinës në Kosovë. Popullata civile kundër së cilës u drejtua sulmi përfshinte popullatën civile serbe në këto komuna si edhe civilë të cilët konsideroheshin se bashkëpunonin me serbët, ose ndryshe si mospërkrahës të UÇK-së. Secili prej Të Akuzuarve e dinte se sjellja e tij që përfshinte vrasje, tortura, rrëmbime, transferime të dhunshme, veprime përndjekëse,

veprime çnjerëzore, burgime të paligjshme dhe veprime të tjera dhune kundër civilëve serbë dhe civilëve shqiptarë kosovarë, romë/egjiptianë kosovarë dhe civilëve të tjerë që janë akuza të kësaj aktakuze, ishte pjesë e sulmit.

16. Gjatë gjithë kohës që lidhet me këtë aktakuzë, **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** ishin të detyruar t'u bindeshin ligjeve dhe zakoneve që rregullojnë kryerjen e konflikteve të armatosura, duke përfshirë Konventat e Gjenevës të vitit 1949.

### **PËRGJEGJËSIA PENALE INDIVIDUALE**

17. **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** akuzohen secili individualisht në bazë të Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit për përgjegjësi penale në lidhje me krimet e akuzuara në këtë aktakuzë.
18. “Kryerja” në këtë Aktakuzë përfshin kryerjen fizike të një krimi me anë të veprimeve ose mosveprimeve ose pjesëmarrjes së të Akuzuarve në një ndërmarrje të përbashkët kriminale (NPK)
19. Çdo i Akuzuar ngarkohet me kryerjen e krimeve të akuzuara si pjesëmarrës në NPK të përshkruara në paragrafët 26 dhe 27. Ndryshe çdo i Akuzuar akuzohet për planifikimin, nxitjen, urdhërimin, kryerjen ose ndryshe për ndihmë dhe inkurajim në planifikimin, përgatitjen ose zbatimin e krimeve të parashtruara në pikat e përmendura në paragrafët 22-24.

20. Në lidhje me kategoritë e përgjegjësisë së planifikimit, nxitjes ose urdhërimit të krimeve të akuzuara, secili i Akuzuar veproi me dijeninë e gjasës thelbësore se në zbatimin e planit, urdhërimit ose nxitjes do të kryheshin krime. Përsa i përket përgjegjësisë së ndihmës dhe inkurajimit çdo i Akuzuar ishte i vetëdijshëm se veprimet ose mosveprimet e tij ndihmuan në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë ose ishte i vetëdijshëm se ndoshta do të kryheshin një numër krimesh dhe se veprimet ose mosveprimet e tij do të ndihmonin në kryerjen e një krimi ose krimeve të tilla.
21. Të tëra veprimet ose mosveprimet e akuzuara si përndjekje u kryen prej një të Akuzuari me synim për t'i diskriminuar viktimat mbi bazë të konsideratave fetare, politike, racore ose një kombinim të tyre ose u planifikuan, nxitën, urdhëruan ose u ndihmuan dhe inkurajuan prej një të Akuzuari me dijeninë e gjasës thelbësore se në zbatimin e urdhrit, planit ose nxitjes, ose si rezultat i ndihmës dhe inkurajimit do të ndodhte përndjekje si krim kundër njerëzimit.
22. Si alternativë ndaj përgjegjësisë së tij në NPK, **Ramush Haradinaj** si individ është penalisht përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në kuptimin që ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara dhe të akuzuara në Pikat 1, 2, 3, 4, 15, 16, 23, 24, 31, 32, 33 dhe 34 të aktakuzës.
23. Si alternativë ndaj përgjegjësisë së tij në NPK, **Idriz Balaj** është si individ penalisht përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në kuptimin që ai planifikoi, nxiti, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet

- e përshkruara dhe të akuzuara në Pikat 7, 8, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 23, 24, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37 të aktakuzës.
24. Si alternativë ndaj përgjegjësisë së tij në NPK, **Lahi Brahimaj** është si individ penalisht përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e tij në kuptimin që ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përmendura dhe të akuzuara në Pikat 23, 24, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33 dhe 34 të aktakuzës.

### **NDËRMARRJA E PËRBASHKËT KRIMINALE**

25. **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj dhe Lahi Brahimaj** janë penalisht përgjegjës si pjesëmarrës në NPK për krimet e akuzuara në çdo pikë të aktakuzës. Çdo krim i akuzuar në aktakuzë përfshihej në qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së dhe secili i Akuzuar kishte të njëjtin synim me bashkëkryesit e tjerë për kryerjen e këtyre krimeve. Ndryshe nëqoftëse disa prej krimeve të akuzuara nuk përfshiheshin në NPK, ato ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të NPK-së dhe secili i Akuzuar ishte i vetëdijshëm se këto krime ishin pasoja të natyrshme dhe parashikueshme të zbatimit të NPK-së
26. Qëllimi i përbashkët kriminal i NPK-së ishte konsolidimi i kontrollit të plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës mbi Zonën Operative të Dukagjinit përmes largimit të paligjshëm dhe keqtrajtimit të civilëve serbë dhe përmes keqtrajtimit të civilëve shqiptarë kosovarë, romë/egjiptianë kosovarë dhe civilëve të tjerë, të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me forcat serbe ose se nuk e

kishin përkrahur UÇK-në. Qëllimi i përbashkët kriminal përfshinte kryerjen e krimeve kundër njerëzimit sipas Nenit 5 dhe shkeljet e ligjeve ose zakoneve të luftës sipas Nenit 3 ndër të cilat vrasje, përndjekje, veprime çnjerëzore, trajtim mizor, burgime të paligjshme dhe tortura. NPK-ja përfshinte ngritjen dhe funksionimin e objekteve të burgimit të UÇK-së dhe keqtrajtimin e personave të mbajtur në këto objekte, ndër të tjera në selitë e shtabeve të UÇK-së në Jabllanicë dhe në Gllogjan dhe në shtabin e Shqiponjave të Zeza në Irzniq.

27. NPK-ja filloi në mars 1998 ose rreth kësaj kohe dhe vazhdoi së paku deri nga fundi i shtatorit 1998. Ndër anëtarët e saj përfshiheshin **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj, Lahi Brahimaj** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së që kishin të njëjtin synim për kryerjen e krimeve të cilat përfshiheshin në qëllimin e përbashkët kriminal të NPK-së dhe të cilët morën pjesë në kryerjen e krimeve të akuzuara në këtë aktakuzë ose përndryshe kontribuan në arritjen e qëllimit të përbashkët kriminal të NPK-së. Anëtarët e tjerë të UÇK-së të cilët kishin të njëjtin synim për kryerjen e krimeve që përfshiheshin në qëllimin e përbashkët kriminal ishin ndër të tjerë vëllezërit e **Ramush Haradinajt**, Daut Haradinaj, Frashër Haradinaj dhe Shkëlzen Haradinaj, dhe të tjerë ndër të cilët Nasim Haradinaj, Zeqir Nimonaj, Luan Përvorfi, Krist Përvorfi, Nazmi Brahimaj, Naser Brahimaj i njohur si “Rusi”. Alush Agushi, Myftar Brahimaj, Pjetër Shala, Arbnor Zejneli dhe Azem Veseli.
28. Me anë të pjesëmarrjes në NPK, çdo i Akuzuar është individualisht përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e dy të bashkakuzuarve si dhe për veprimet dhe mosveprimet e anëtarëve të tjerë të NPK-së që

ishin për realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal dhe që ose përfshiheshin në objektivin e NPK-së ose ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të saj.

29. Çdo i Akuzuar është gjithashtu përgjegjës për veprimet dhe mosveprimet e personave të tjerë të cilët nuk ishin anëtarë të NPK-së, por të cilët u përdorën prej anëtarëve të NPK-së për kryerjen e krimeve në realizimin e qëllimit të përbashkët kriminal të cilat ose përfshiheshin në qëllimin e NPK-së ose ishin pasoja të natyrshme dhe të parashikueshme të zbatimit të saj.

**PJESËMARRJA E ÇDO TË AKUZUARI NË NDËRMARRJEN E PËRBASHKËT KRIMINALE**

30. **Ramush Haradinaj** mori pjesë në NPK ndër të tjera, nëpërmjet këtyre veprimeve ose mosveprimeve:
- (a) duke mundësuar si Komandant i Zonës Operative të Dukagjini që forcat e UÇK-së nën kontrollin e tij të vepronin në mënyrë të strukturuar dhe të disiplinuar dhe duke kontrolluar, planifikuar dhe organizuar operacionet e UÇK-së;;
  - (b) duke lejuar që UÇK-ja nën kontrollin dhe drejtimin e tij, të krijonte një sistem përmes të cilit civilët serbë, shqiptarë kosovarë dhe romë/eigjiptianë kosovarë të cilët bashkëpunonin ose mendohej se kishin bashkëpunuar me Forcat Serbe ose që ndryshe nuk e kishin përkrahur UÇK-në, u vunë në shënjestër për rrëmbime, vrasje, burgim dhe forma të tjera të keqtrajtimit;

- (c) duke përjashtuar të gjithë rivalët e forcave të UÇK-së, si Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK) nga Zona Operative e Dukagjinit me qëllim që t'u siguronte ushtarëve të tij aftësinë për të mbizotëruar në zonë dhe për të përndjekur civilë;
- (d) duke e përdorur shtëpinë e vet si qendër operative dhe duke i shfrytëzuar burimet e tjera të familjes Haradinaj dhe përkrahjen e anëtarëve të familjes së tij për të fuqizuar më tej pushtetin e tij, duke synuar ndër të tjera, zbatimin e NPK-së, duke përfshirë edhe përndjekjen e civilëve;
- (e) duke miratuar krijimin e njësisë famëkeqe “Shqiponjat e Zeza” që kreu sulme ndaj civilëve dhe i keqtrajtoi ata;
- (f) duke emëruar dhe mbajtur të bashkakuzuarin e tij, **Idriz Balaj** si Komandant të “Shqiponjave të Zeza”;
- (g) duke emëruar **Lahi Brahimajn** dhe më pas, Nazmi Brahimajn si Zëvendëskomandant të Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe si ushtarak përgjegjës i UÇK-së në objektin e burgimit të Jabllanicës ku u mbajtën dhe u keqtrajtuat civilë;
- (h) duke planifikuar, ngritur dhe vënë në funksionim objekte burgimi, ndër të cilët objekti i burgimit në Jabllanicë, të cilat u përdorën për mbajtjen e paligjshme dhe keqtrajtimin e civilëve;
- (i) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të bashkakuzuarve të tij dhe ushtarëve të UÇK-së kur ai ishte i pranishëm në objektin e burgimit në Jabllanicë;
- (j) duke kontrolluar burgimin e mëtejshëm, lirim, ose trajtimin mjekësor të civilëve të mbajtur nga UÇK-ja në Zonën Operative të Dukagjinit, përfshirë objektin e burgimit të Jabllanicës;

- (k) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të Bashkakuzuarve të tij dhe të vartësve të tjerë në Zonën Operative të Dukagjinit, në vende si objekti i burgimit në Jabllanicë, shtabi i Baranit, shtabi i Gllogjanit dhe shtabi i Irzniqit
  - (l) duke dhënë miratimin e tij të heshtur për ekzekutimin e personave të burgosur; dhe
  - (m) nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ndër të tjera ato në Pikat 1, 2, 3, 4, 15, 16, 23, 24, 31, 32, 33 dhe 34 ku ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara dhe të akuzuara;
31. **Idriz Balaj** mori pjesë në NPK ndër të tjera, nëpërmjet këtyre veprimeve ose mosveprimeve:
- (a) duke bashkëpunuar ngushtë si Komandant i “Shqiponjave të Zeza”, me **Ramush Haradinajn** dhe duke siguruar përkrahje të drejtpërdrejtë operative për veprimtaritë kriminale të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit;
  - (b) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të anëtarëve të “Shqiponjave të Zeza” që ishin vartësit e tij dhe atë të anëtarëve të tjerë të UÇK-së;
  - (c) duke përdorur dhe duke lejuar përdorimin e shtabit të Shqiponjave të Zeza në Irzniq, ndër të tjera për qëllimin e zbatimit të NPK-së nëpërmjet keqtrajtimit, përdhunimit dhe vrasjes së civilëve;

- (d) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të Bashkakuzuarve të tij dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së në objektin e burgimit në Jabllanicë;
  - (e) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale që ai pa në objektin e burgimit në Irzniq kryer nga individë, ndër të cilët anëtarë të “Shqiponjave të Zeza”;
  - (f) duke u përpjekur të pengonte hetimin dhe të mbante të fshehtë rrëmbimet dhe vrasjet e civilëve dhe hedhjen e kufomave të tyre në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit; dhe
  - (g) nëpërmjet veprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ndër të tjera ato në Pikat 7, 8, 13, 14, 17, 18, 19, 20, 23, 24, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37, ku ai planifikoi, nxiti, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara dhe të akuzuara;
32. **Lahi BRAHIMAJ** mori pjesë në NPK ndër të tjera, nëpërmjet këtyre veprimeve ose mosveprimeve:
- (a) duke bashkëpunuar ngushtë si Zëvendëskomandant i Shtabit Operativ të Dukagjinit dhe si komandant në UÇK-së me Ramush Haradinajn dhe duke dhënë përkrahje të drejtpërdrejtë operative për veprimtaritë kriminale të UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit;
  - (b) duke drejtuar objektin e burgimit në Jabllanicë së paku prej prillit 1998 deri më 5 korrik 1998 ose rreth kësaj date, ndër të tjera për zbatimin e NPK-së nëpërmjet burgimit dhe keqtrajtimit të civilëve;

- (c) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të të Bashkakuzuarve të tij dhe të ushtarëve të tjerë të UÇK-së në objektin e burgimit në Jabllanicë gjatë asaj periudhe kohore dhe më pas, së paku deri në mes të shtatorit 1998;
  - (d) duke miratuar dhe inkurajuar sjelljen kriminale të ushtarëve të UÇK-së ndër ta edhe të policisë ushtarake dhe persona të tjerë të cilët sulmuan dhe ndryshe keqtrajtuan civilë në Zonën Operative të Dukagjinit; dhe
  - (e) prej veprimeve dhe mosveprimeve të tij në veprimtaritë kriminale të përshkruara në këtë aktakuzë, ndër të tjera ato në Pikat 23, 24, 25, 26, 27, 28, 31, 32, 33 dhe 34 ku ai planifikoi, nxiti, urdhëroi, kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi krimet e përshkruara dhe të akuzuara.
33. Hollësitë e tjera të funksionimit të NPK-së dhe pjesëmarrjes së secilit të akuzuar jepen në akuzat dhe paraqitjen e mëposhtme të fakteve.

### **PARAQITJA E FAKTEVE**

34. Në 1998, komuna e Deçanit kishte 57,125 banorë, prej të cilëve 55,886 ishin shqiptarë, 791 ishin serbë dhe 448 ishin të përkatësive të tjera etnike. Komuna e Gjakovës kishte rreth 131,700 banorë, prej të cilëve 122,856 ishin shqiptarë, 3,211 serbë, dhe 5,680 të përkatësive të tjera etnike. Komuna e Istogut kishte rreth 64,000 banorë, prej të cileve 51,343 ishin shqiptarë, 7,270 serbë, dhe 5,381 të përkatësive të tjera etnike. Komuna e Klinës kishte rreth 75,000 banorë, prej të cileve 66,683 ishin shqiptarë, 6,306 ishin serbë, dhe 3,386 të

- përkatësive të tjera etnike. Komuna e Pejës kishte rreth 150,000 banorë prej të cileve 111,638 ishin shqiptarë, 14,765 serbë, dhe 13,788 të përkatësive të tjera etnike.
35. Herët në 1998, u ashpërsua konflikti midis autoriteteve serbe dhe UÇK-së në rajonin e Gllogjanit. Deri në fillim të shtatorit 1998, shtabi i UÇK-së i **Ramush Haradinajt** ndodhej në oborrin e familjes së tij në fshatin e lindjes në Gllogjan. Rajoni midis Gllogjanit dhe Deçanit ishte me rëndësi kyçe strategjike për UÇK-së, sepse ai lidhte shtabin e UÇK-së të **Ramush Haradinajt** në Gllogjan me kufirin me Shqipërinë prej ku UÇK-ja mori armë dhe furnizime gjatë tërë vitit 1998. Gllogjani u bë gjithashtu qendër e rëndësishme rekrutimi për UÇK-në në rajonin e Dukagjinit dhe në Zonat Operative të Shalës, Llapit dhe Drenicës.
36. Forcat e UÇK-së kryen sulme ndaj caqeve të policisë serbe në rajonin e Dukagjinit dhe gjithashtu ndaj një kampi të afërt të refugjatëve serbë/malazezë që gjendej në fshatin Baballoq dhe si pasojë më 24 mars 1998 forcat e policisë serbe e rrethuan oborrin e familjes së **Ramush Haradinajt** në Gllogjan. **Ramush Haradinaj** dhe forcat e UÇK-së nën komandën e tij e zmbarsën këtë sulm me sukses. Një polic serb u vra dhe **Ramush Haradinaj** u plagos.
37. Pas 24 marsit 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** nisën një fushatë ushtarake për marrjen nën kontroll të rajonit midis fshatrave Gllogjan dhe Deçan dhe veçanërisht fshatrat Dubravë, Irzniq, Ratishë dhe Dashinoc dhe për largimin e

- serbëve etnikë prej fshatrave ku banonin. Gjithashtu ata vazhduan me sulme kundër kampit të refugjatëve në Baballoq. Ky kamp refugjatësh kishte qenë objekt sulmesh të ngjashme të UÇK-së që prej vitit 1997.
38. Gjatë marsit dhe prillit 1998 forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt**, duke përfshirë “Shqiponjat e Zeza” nën komandën e drejtpërdrejtë të **Idriz Balajt** kërcënuan psikologjikisht ose fizikisht në mënyrë të përsëritur, rrahën ose përndryshe larguan civilë serbë dhe civilë romë/egjiptianë prej këtyre fshatrave dhe vranë shumë civilë serbë ose romë egjiptianë që mbetën ose që kishin refuzuar t’i braktisnin shtëpitë e tyre. Në gjysmën e dytë të prillit 1998, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** arritën të bllokonin pjesë të Deçanit për një periudhë afro trijavëshe.
39. Deri në mes të prillit 1998 shumë prej popullatës serbe që jetonin në Zonën Operative të Dukagjinit kishin ikur nga rajoni pas veprimeve të dhunës dhe përndjekjes së UÇK-së ndaj civilëve serbë. Brenda disa ditëve pas 19 prillit 1998, prej sulmeve të UÇK-së u larguan ose u vranë praktikisht të gjithë civilët e mbetur serbë në pjesët e kontrolluara prej UÇK-së në Zonën Operative të Dukagjinit.
40. Gjatë muajve vijues brenda Zonës Operative të Dukagjinit, dhe në veçanti në komunat e Deçanit dhe Pejës, forcat e UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** vazhduan sulme të ngjashme ndaj civilëve serbë, shqiptarë kosovarë dhe romë/egjiptianë kosovarë ose civilëve të tjerë që konsideroheshin si bashkëpunëtorë,

ose të cilët konsideroheshin si mospërkrahës të UÇK-së, dhe të cilit nuk merrnin pjesë në luftime. Forca të UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** kryen rrëmbime në Zonën Operative të Dukagjinit. Gjatë periudhës mars-shtator 1998 dhjetra civilë u zhdukën në komunat e Zonës Operative të Dukagjinit, përveç viktimave të përmendura në këtë aktakuzë, UÇK-ja rrëmbeu më shumë se 60 civilë dhe më pas vrau shumë prej tyre.

41. Fshati Jabllanicë ndodhet në komunën e Gjakovës, afërsisht 18km nga Gllogjani. Nga fundi i vitit 1995 **Lahi Brahimaj**, i cili jetonte në Jabllanicë strehoi anëtarë të tjerë të UÇK-së në shtëpinë e tij dhe i ndihmoi ata në kalimin e tyre përmes rajonit të Dukagjinit. U ngrit një depo armësh dhe shtëpia e **Lahi Brahimajt** përdorej për tubime të fshehta. Gjatë kësaj periudhe në rajonin e Dukagjinit nuk u kryen aksione me armë.

42. Së paku prej marsit të vitit 1998 shtabi i UÇK-së së Jabllanicës strehonte anëtarë të lartë të UÇK-së të cilët hynin në Kosovë dhe shkonin në rajone të tjera të krahinës për ngritjen e komandave. **Ramush Haradinaj** shkoi në shtabin e Jabllanicës për trajtim mjekësor dhe për t'u shëruar prej plagëve që iu shkaktuan më 24 mars 1998 kur ndodhi ndeshja me armë me forcat serbe në oborrin e familjes së tij në Gllogjan. Pas një ofensive të Forcave Serbe në fillim të shtatorit 1998 **Ramush Haradinaj** e zhvendosi shtabin e tij të UÇK-së në oborrin familjar të **Lahi Brahimajt** në Jabllanicë.
43. Në mes të majit 1998 UÇK-ja ngriti një objekt të improvizuar burgimi në shtabin e Jabllanicës. Objekti i burgimit të Jabllanicës ndodhej në një shtëpi me katër dhoma ngjitur me oborrin familjar të **Lahi Brahimajt** ku ndodhej shtabi i UÇK-së për Jabllanicën. **Lahi Brahimaj** kishte një zyrë në shtëpi. Përgjithësisht UÇK-ja i mbante të burgosurit së bashku në një dhomë me madhësi afërsisht 16 metër katror dhe pa orendi. Disa të burgosur u flakën në bodrumin e shtëpisë që ishte mbushur me ujë deri në lartësinë gjysëm metër dhe u mbajtën atje. Gjatë burgimit të burgosurve u jepej shumë pak ushqim dhe ujë, rriheshin rregullisht dhe iu nënshtruan formave të tjera të keqtrajtimit fizik dhe iu mohua trajtimi mjekësor për lëndimet e tyre. Një numër të burgosurish në objektin e burgimit të Jabllanicës vdiqën si pasojë e lëndimeve të tyre ose u ekzekutuan me urdhër të të Akuzuarve.
44. Liqeni i Radoniqit dhe kanali prej betoni i cili vjen pej lumit dhe derdhet në liqen ishin brenda Zonës Operative të Dukagjinit. Kanali

rrjedh afërsisht dy kilometra larg Gllogjanit. Gjatë periudhës së aktakuzës, ushtarë të UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** kontrollonin territorin përreth liqenit. Për të udhëtuar në këtë zonë kërkohej lejëkalimi prej UÇK-së. Rrethina e kanalit të Liqenit të Radoniqit ishte vendi i preferuar i ekzekutimit prej **Idriz Balajt**. Banorët vendës kishin frikë të shkonin në atë vend për shkak të frikës prej hakmarrjes nga Idriz Balaj dhe anëtarët e Shqiponjave të Zeza.

45. Gjatë fundit të gushtit dhe fillimit të shtatorit 1998, Forcat Serbe nisën një kundërofensivë dhe rimorën përkohësisht rajonin rreth Gllogjanit duke përfshirë edhe rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
46. Një ekip serb i mjekësisë ligjore për vendin e krimit kreu një hetim në afërsi të kanalit që çon në Liqenin e Radoniqit, dhe në rrugën që çon në Dashinoc.
47. Më 12 shtator 1998 ose rreth kësaj date, ekipi gjeti mbetje të 32 kufomave të identifikueshme në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit. Shumë prej kufomave u gjetën pranë njërit prej vetëm dy shtigjeve që të çonin në rrethinë. Ekipi gjeti edhe dy kufoma në rrugën që çon në Dashinoc, afërsisht nëntë kilometra prej Gllogjanit.
48. Kufomat dhe mbetjet u ekzaminuan nga mjekësia ligjore në një morg provizor në Gjakovë. Disa prej mbetjeve të gjetura në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit dhe në rrugën që çon në Dashinoc u identifikuan prej autoriteteve serbe me anë të procedurave tradicionale

të identifikimit. Këtu përfshihen këta nëntë persona: Vukosava Markoviq(Vukosava Marković) dhe Darinka Kovaç(Darinka Kovač) (Pikat 7 dhe 8); Millosh Radunoviq(Miloš Radunović) dhe Slobodan Radosheviq(Slobodan Radošević) (Pikat 11 dhe 12); Hajrullah Gashi dhe Isuf Hoxha (Pikat 15 dhe 16); Ilira Frrokaj (Pikat 17 dhe 18); dhe Ilia Antiq(Ilija Antić) dhe Velizar Stoshiq(Velizar Stošić) (Pikat 21 dhe 22). Mbetjet e tjera të gjetura u identifikuan më pas prej organizatave ndërkombëtare me anë të provës së ADN-së. Këtu përfshihen këta nëntëmbëdhjetë persona: Milka Vllahoviq(Milka Vlahović) (Pikat 9 dhe 10); nëna dhe një motër e Dëshmitarit SST7/04 (paragrafët 68 dhe 69 të Pikave 13 dhe 14); Zenun Gashi, Misin Berisha dhe Sali Berisha (Pikat 19 dhe 20); Malush Meha, Rade Popadiq(Rade Popadić), Idriz Hoti, Afrim Sylejmani, Zdravko Radunoviq(Zdravko Radunović), Xhevat Berisha, Nuriye Krasniqi, Istref Krasniqi, Kemajl Gashi, Kujtim Imeraj, Sanije Balaj dhe Sejd Noci (Pikat 21 dhe 22) dhe Pal Krasniqi (Pikat 31 dhe 32).

49. Disa prej mbetjeve që u gjetën në vendet e sipërpërmendura mbeten të paidentifikuara megjithëse janë kryer ekzaminime në përpjekje për përcaktimin e identiteteve të tyre. Këto mbetje janë të kufomave të rreth pesë individëve. Të gjitha këto mbetje tregojnë shenja të vdekjes prej dhunës.
50. Gëzhojat dhe municioni i gjetur nga autoritetet serbe në mars 1998 gjatë operacioneve kundër UÇK-së në fshatrat rreth Gllogjanit, Gramaçelit dhe Plançarit janë të të njëjtit prodhim dhe identiteti si ato të gjetura nga autoritetet serbe në shtator 1998 në vendin e zhvarrimit në kanalin e Liqenit të Radoniqit.

## AKUZAT

### PIKAT 1 dhe 2

51. Më 28 maj 1998 tre ushtarë të armatosur të UÇK erdhën në shtëpinë e Dëshmitarit SST7/38 dhe detyruan dëshmitarin dhe familjen e dëshmitarit dhe fqinjët e dëshmitarit t'i lëshonin shtëpitë e tyre dhe t'i bashkoheshin një kolone civilësh të cilët po largoheshin nga Juniku për në drejtim të kufirit shqiptar.
52. Grupi i dëshmitarit iku prej kolonës por u ndal në një postbllok të UÇK-së dhe u urdhërua të ribashkohej me kolonën. Pasi arritën lagjen Gacafer (në periferi të Junikut), ushtarët e UÇK-së i çuan familjen dhe fqinjët e Dëshmitarit SST7/38 në një mulli të vjetër në pyll dhe i detyruan të uleshin përtokë në shi. Afërsisht pas një ore atje erdhi **Ramush Haradinaj**.
53. Një ushtar i UÇK-së i tha **Ramush Haradinajt** se njerëzit e kapur ishin në dispozicion të tij dhe se Dëshmitari SST7/38 kishte informata mbi MPB-në. **Ramush Haradinaj** i urdhëroi ushtarët e UÇK-së të kontrollonin dëshmitarin dhe babanë e dëshmitarit dhe të merrnin informacion prej dëshmitarit, qoftë edhe me forcë. Pastaj **Ramush Haradinaj** u largua.
54. Ushtarët e UÇK-së rrahën babanë e Dëshmitarit SST7/38 dhe lejuan civilë shqiptarë që t'i keqtrajtonin të ndaluarit. Ata e zhveshën lakuriq Dëshmitarin SST7/38 dhe i vunë një thikë në fytyrë, e detyruan

dëshmitarin të hante një librushkë me mbulesë plastike dhe e goditën dëshmitarin në fytyrë me një pistoletë. Dëshmitari dhe babai i dëshmitarit u lidhën së bashku, shpinë më shpinë me tel me gjemba. Ushtarët i kërcënuan se do t'i vrisnin.

55. Gjatë dy ditëve të ardhshme kur kolona vazhdoi udhëtimin drejt Gjocajt ushtarët e UÇK-së poshtëruan dhe keqtrajtuat fizikisht të ndaluarit. Një ushtar i UÇK-së rrahu dhe shkelmoi Dëshmitarin SST7/38 dhe babanë, motrën dhe kunatën e dëshmitarit, dhe i goditi me kondak pushke. Më 29 maj 1998, dëshmitari dhe babai i dëshmitarit u lidhën pas një peme dhe atyre nuk iu dha as ushqim dhe as ujë. Ushtarë të UÇK-së sulmuan seksualisht motrën e Dëshmitarit SST7/38. Dëshmitarit SST7/38 iu refuzua trajtim mjekësor me arsyetimin se dëshmitari do të ekzekutohej.

56. Në mëngjesin e 30 majit 1998, grupi u çua në shtabin e UÇK-së në Gjocaj. Atje, ushtarët e UÇK-së i rreshtuan anëtarët e grupit në buzë të një rrëpire për t'i pushkatuar. Ata arritën t'i shpëtonin ekzekutimit duke vrapuar teposhtë rrëpirës pas ndërhyrjes së një të jashtmi dhe ikën në zonën e kontrolluar nga serbët. UÇK-ja nuk i lejoi Dëshmitarin SST7/38 dhe familjen e dëshmitarit që të ktheheshin në shtëpinë e tyre në Junik.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës në NPK përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 1:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje, (dëbim ose transferim i dhunshëm i civilëve, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim) e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Tortura dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (transferim i dhunshëm, burgim, lëndim fizik dhe mendor), të ndëshkueshme sipas Neneve 5 (f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 2:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Tortura dhe Dhunim i Dinjitetit Personal të njohura në Nenet e Përbashkëta 3(1) (a) dhe 3(1)(c) të Konventave të

Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** urdhëroi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 1 dhe Pikën 2.

**PIKAT 3 dhe 4**

57. Më 18 prill 1998 ose rreth kësaj date, forcat e UÇK-së rrëmbyen tre civilë serbë, Dragosllav Stojanoviqin(Dragoslav Stojanović), Mijat Stojanoviqin(Mijat Stojanović) dhe Veselin Stijoviqin(Veselin Stijović) prej shtëpisë së familjes Stojanoviq në Dubravë.
58. Forcat e UÇK-së morën në pyetje dhe rrahën të ndaluarit duke u shkaktuar lëndime të rënda trupore dhe vuajtje të mëdha. Fillimisht u rrahën në shtëpinë familjare të Stojanoviqëve në Dubravë dhe pastaj në shtabin e UÇK-së në Gllogjan.
59. **Ramush Haradinaj** ishte i pranishëm në ndërtesë në atë kohë, dhe ishte në dijeni për marrjen në pyetje dhe rrahjen e të tre personave. **Ramush Haradinaj** shkëlmoi, kërcënoi dhe frikësoi Dragosllav Stojanoviqin.
60. Më vonë atë ditë, ushtarë të UÇK-së nën komandën dhe kontrollin e **Ramush Haradinajt** i çuan Dragosllav Stojanoviqin, Mijat Stojanoviqin dhe Veselin Stijoviqin prej shtabit të UÇK-së në

Gllogjan në një vend afër fshatit Baballoq ku atyre iu lidhën sytë, u urdhëruan të ecnin drejt rajonit serb dhe u kërcënuan se do të ekzekutoheshin po të shikonin prapa. Të tre shkuan në pjesën serbe të Baballoqit. Andej ata u çuan në një klinikë në qytetin e Deçanit ku u mjekuan fillimisht për lëndimet dhe pastaj në spital në qytetin e Pejës ku ata u mjekuan më tej për lëndimet e rënda që kishin pësuar prej rrahjeve. Ata nuk mund të ktheheshin në shtëpitë e tyre për sa kohë që zona ishte nën kontrollin e UÇK-së. Pas ripushtimit të zonës prej Forcave Serbe në fund të gushtit apo fillim të shtatorit Mijat Stojanoviqi mundi të shkonte në shtëpinë e familjes së tij në Dubravë të cilën e gjeti krejtësisht të shkatërruar.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 3:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (dëbim ose transferime të dhunshme, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim) e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Tortura dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (transferim i dhunshëm, burgim, lëndim i rëndë fizik dhe mendor) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 4:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim mizor dhe Tortura të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1) (a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Neneve 3 dhe 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruar në Pikën 3 dhe në Pikën 4.

**PIKAT 5 dhe 6**

61. Më 23 prill 1998 ose rreth kësaj date, tre civilë serbë, Roza Radosheviqi(Rosa Radošević), djali i saj, Stanisha Radosheviqi(Staniša Radošević) dhe Novak Stijoviqi(Novak Stijović) u ndalën dhe u kontrolluan nga ushtarët e UÇK-së në fshatin Pozhar. Ushtarët e UÇK-së i rrëmbyen të tre, konfiskuan automjetet e tyre dhe i çuan në Gllogjan. Atje, ushtarët e UÇK-së nën komandën e **Ramush Haradinajt** morën në pyetje Stanisha Radosheviqin dhe Noval Stijoviqin ndërkohë që i goditnin në mënyrë të përsëritur me grushta, shkelma dhe me shufra metalike duke u shkaktuar në këtë mënyrë vuajtje të mëdha. Rrahja ishte kaq e rëndë saqë Novak Stijoviqi humbi ndjenjat. UÇK-ja i liroi të tre nga burgimi po atë ditë.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 5:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Burgim, Tortura, dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(e) dhe 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 6:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Tortura, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1) (a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

## **PIKAT 7 dhe 8**

62. Midis 21 prillit 1998 dhe 12 shtatorit 1998, motratt serbe Vukosava Markoviq dhe Darinka Kovaç, u rrëmbyen prej shtëpisë së tyre në fshatin Ratishë nga **Idriz Balaj** dhe ushtarë të UÇK-së. Pastaj **Idriz Balaj** i vuri zjarrin shtëpisë së tyre. Të dyja gratë u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja. Më 12 shtator 1998 një ekip serb i mjekësisë ligjore gjeti kufomat e tyre në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit. Ekzaminimi mjeko-ligjor zbuloi plagë prej armëve të zjarrit në të dyja kufomat dhe thyerje të shumta eshtërore në kufomën e Vukosava Markoviqit.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 7:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 8:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Idriz Balaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 7 dhe Pikën 8;

## **PIKAT 9 dhe 10**

63. Më 21 prill 1998 ose rreth kësaj date ushtarët e UÇK-së rrëmbyen dy serbë, Millovan Vllahoviqin dhe gruan e tij Milka Vllahoviqin të cilët jetonin në fshatin Ratishë. Shqiptarët vendës, të cilët u përpoqën të pengonin rrëmbimin, u kërcënuan me vdekje po të ndërhyenin. Pastaj të dy serbët u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja.

- 64 Kufoma e Millovan Vllahoviqit nuk është gjetur. Mbetjet e kufomës së Milka Vllahoviqit u gjetën në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit në 1998 dhe më vonë u identifikuan prej analizës së ADN-së.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 9:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 10:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

## **PIKAT 11 dhe 12**

65. Midis 19 prillit 1998 dhe shtatorit 1998 ushtarë të UÇK-së rrëmbyen dy serbë që jetonin në fshatin Dashinoc, Slllobodan Radosheviqin dhe fqinjin e tij Millosh Radunoviqin. Ata u vranë më pas gjatë burgimit nga UÇK-ja.

66. Më 12 shtator 1998 policia serbe i gjeti mbetjet e kufomave të Slllobodan Radosheviqit dhe Millosh Radunoviqit afër Dashinocit.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 11:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 12:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

### **PIKAT 13 dhe 14**

67. Nga prilli i vitit 1998 **Idriz Balaj** dhe ushtarë të armatosur të UÇK-së nën komandën e tij shkuan në mënyrë të përsëritur në shtëpinë e familjes së dëshmitarit SST7/04 në Ratishë, shpesh natën vonë. Gjatë vizitave të tyre ata u bërtitën dhe i shanë anëtarët e familjes, i kërcënuan me jetë, bastisën shtëpinë dhe morën të holla dhe gjësende. Si pasojë e kësaj praktike keqtrajtuese dhe vënies së përsëritur në shënjestër të anëtarëve të familjes së tij, Dëshmitari SST7/04 dhe

- anëtarët e familjes së tij u detyruan të iknin prej shtëpisë së tyre të frikësuar për vdekje.
68. Në prill ose në maj 1998 **Idriz Balaj** dhe dy ushtarë të UÇK-së rrëmbyen një motër të Dëshmitarit SST7/04 nga shtëpia e familjes në Ratishë. Atë e çuan në shtabin e Shqiponjave të Zeza të UÇK-së në fshatin Irzniq dhe e mbajtën së paku atë natë. Pastaj ushtarët e kthyen në shtëpinë e saj. **Idriz Balaj** i kërkoi asaj të kthehej në shtabin e UÇK-së, ndryshe e priste ekzekutimi. Familja e saj e pa atë për herë të fundit duke shkuar në drejtim të shtabit të Shqiponjave të Zeza në Irzniq. Ajo u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Mbetja e kufomës së saj u gjet në rrethinën e kanalit të Radoniqit në shtator 1998.
69. Herët në verën e vitit 1998 dhe pas zhdukjes së një motre të Dëshmitarit SST7/04, **Idriz Balaj** dhe ushtarë të maskuar të UÇK-së morën në pyetje nënën e Dëshmitarit SST7/04 në shtëpinë e saj në Ratishë dhe pastaj e rrëmbyen. Familja e saj u urdhërua të qëndronte në shtëpinë e tyre ndërsa atë e morën me vete. Ajo u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja dhe mbetjet e kufomës së saj u gjetën më vonë në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
70. Herët në vjeshtë të vitit 1998, dhe pas rrëmbimeve të motrës së parë dhe nënës së Dëshmitarit SST7/04, **Idriz Balaj** dhe ushtarë të Shqiponjave të Zeza sulmuan shtëpinë e Dëshmitarit SST7/04 me armë zjarri. Ata rrëmbyen një motër të dytë të Dëshmitarit SST7/04 nën tytat e armëve. Ushtarët e UÇK-së e vranë motrën e dytë. Kufoma e saj u gjet pas disa ditësh afër Zhabelit.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 13:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, rrëmbim, kërcënime psikologjike ose fizike të përsëritura), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (kërcënime psikologjike ose fizike të përsëritura, burgim), të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a) dhe 5 (i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 14:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Idriz Balaj** kreu ose planifikoi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 13 dhe Pikën 14;

### **PIKAT 15 dhe 16**

71. Më 20 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Hajrullah Gashi dhe Isuf Hoxha, të dy shqiptarë të Kosovës, po udhëtonin me një autobus i cili u ndal në një stacion autobusi në Malishevë prej **Ramush Haradinajt**

dhe ushtarëve të UÇK-së nën komandën e tij. **Ramush Haradinaj** dhe ushtarët e UÇK-së morën Hajrullah Gashin dhe Isuf Hoxhën prej autobusit dhe i çuan me makinë në drejtim të Gllogjanit.

72. Të dy personat u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja në një datë të panjohur midis kohës së rrëmbimit të tyre dhe 12 shtatorit 1998 kur kufomat e tyre u gjetën nga policia serbe në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit. Ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së Hajrullah Gashit zbuloi plagë që përputheshin me një traumë të shkaktuar prej një mjeti jo të mprehtë. Ekzaminimi mjeko-ligjor i kufomës së Isuf Hoxhës zbuloi thyerje të shumta eshtrërore dhe mungesën e disa eshtrave të kafkës.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 15:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (burgim), të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 16:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të

Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** kreu ose planifikoi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 15 dhe Pikën 16;

**PIKAT 17 dhe 18**

73. Ilira Frrokaj dhe burri i saj Tush Frrokaj, të dy shqiptarë kosovarë katolikë, jetonin në fshatin Plançar. Në gusht 1998 kur ata po udhëtonin me makinë për në fshatin Nepalë, ushtarë të UÇK-së, ndër të cilët edhe **Idriz Balaj**, i ndalën në një postbllok dhe i rrëmbyen.
74. Ilira Frrokaj dhe Tush Frrokaj u vranë që të dy gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e Ilira Frrokajt u gjet ngjitur me automjetin e saj në kanalin e Liqenit të Radoniqit. Automjeti kishte disa vrima plumbash. Kufoma e Ilira Frrokajt kishte një fishek në njërën këmbë, thyerje të shumta eshtërore, duke përfshirë thyerje të kafkës, dhe shenja të djegjes së trupit. Kufoma e Tush Frrokajt nuk është gjetur.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 17:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (burgim), të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 18:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim mizor, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Idriz Balaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 17 dhe Pikën 18.

### **PIKAT 19 dhe 20**

75. Më 1 gusht 1998 ushtarë të UÇK-së rrëmbyen Zenun Gashin, rom/egjiptian kosovar, ish-polic, prej shtëpisë së tij në fshatin Kosuriq, e rrahën dhe e çuan në shtabin e Shqiponjave të Zeza në Irzniq.
76. Në periudhën 1 gusht - 31 gusht 1998 **Idriz Balaj** mbajti Zenun Gashin, Misin Berishën dhe djalën e tij, Sali Berishën, të gjithë romë,

në shtabin e Shqiponjave të Zeza në Irzniq. Ata u burgosën për shkak se konsideroheshin se bashkëpunonin me Forcat Serbe.

77. Gjatë burgimit të tyre **Idriz Balaj** dhe ushtarë të UÇK-së i keqtrajtuuan egërsisht të tre burrat. Sali Berishës iu pre hunda në praninë e **Idriz Balajt**. **Idriz Balaj** i çau të tre personat në qafë, në krahë dhe në kofshë, ua fërkoi plagët me kripë dhe i qepi me gjilpërë. **Idriz Balaj** i mbështolli të tre burrat në tel me gjemba, duke ua ngulur gjembat e telit në mish. **Idriz Balaj** e goditi Zenun Gashin në sy me thikë. Të tre burrat u lidhën pas automjetit të **Idriz Balajt** dhe u tërhoqën zvarrë në drejtim të Liqenit të Radoniqit. Ata u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufomat e tyre u gjetën në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit dhe më pas u identifikuan prej analizës së ADN-së.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 19:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, Burgim, Tortura, dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a), 5(e), 5 (f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 20:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor dhe Tortura, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Idriz Balaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 19 dhe Pikën 20;

**PIKAT 21 dhe 22**

78. Në prill 1998 u zhduk Afrim Sylejmani, shqiptar kosovar, banor i Gjakovës. Më pas ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Në shtator 1998 kufoma e tij u gjet në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
79. Më 24 maj 1998 ose rreth kësaj date, Rade Popadiqi, inspektor policor serb u rrëmbye nga anëtarë të UÇK-së kur po udhëtonte në një kombi në rrugën midis Baballoqit dhe Junikut me një koleg të tij polic. Më pas ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Në shtator 1998 kufoma e tij u gjet në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
80. Më 27 maj ose 28 maj 1998, Ilia Antiqi, serb që jetonte në Lloçan u pa për herë të fundit i gjallë kur ai vizitoi shtëpinë e vëllait të tij Gjorgje Antiqit(Đorđe Antić), në Lloçan. Anëtarët e tjerë të familjes tashmë ishin larguar nga fshati për shkak të incidenteve me të shtëna armësh prej UÇK-së. Ilia Antiqi u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Autoritetet serbe e gjetën kufomën e tij në shtator 1998 në rrethinën e

kanalit të Liqenit të Radoniqit. Në kufomë u zbuluan thyerje të shumta eshtërore, përfshirë edhe lëndime të kafkës.

81. Idriz Hoti, shqiptar kosovar, banor i Gjakovës, u zhduk në qershor ose korrik 1998. Më pas ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
82. Më 4 korrik 1998 ushtarë të UÇK-së rrëmbyen Kujtim Imerajn, rom/egjiptian, në fshatin Novosellë e Poshtme. Më pas ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
83. Më 12 korrik 1998 ushtarë të UÇK-së rrëmbyen Nuriye Krasniqin dhe Istref Krasniqin, të dy shqiptarë kosovarë prej shtëpisë së tyre në fshatin Turjakë. Ata u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufomat e tyre u gjetën në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
84. Më 18 korrik 1998 Zdravko Radunoviqi, serb, u zhduk pasi doli prej shtëpisë së tij në Pejë. Ushtarë të UÇK-së e rrëmbyen në fshatin Dujakë dhe e çuan në fshatin Gllogjan ku ata ia dorëzuan një komandanti të atjeshëm të UÇK-së. Gjatë burgimit nga UÇK-ja ai u qëllua me plumb në kokë dhe u vra. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
85. Velizar Stoshiqi, serb i cili jetonte në Bellopojë, u zhduk më 19 korrik 1998 në Llokhë. Velizar Stoshiqi u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja dhe

- kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit. Ekzaminimi i kufomës zbuloi plagë prej arme zjarri në kokë dhe në këmbë dhe te qafa u gjet një lak litari.
86. Malush Shefki Meha, shqiptar kosovar, u largua nga shtëpia e tij në Pejë më 27 korrik 1998 ose rreth kësaj date. Ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
87. Xhevat Berisha, rom/egjiptian, u zhduk në gusht 1998 nga fshati Gllogjan. Ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
88. Në verë të vitit 1998, Kemajl Gashi, shqiptar kosovar u largua nga shtëpia e tij në Pejë. Djali i tij anëtar i UÇK-së në Baran, e pa për herë të fundit babanë e tij në kazermën e UÇK-së në Baran. Komandanti i UÇK-së në Baran i tha se babai i tij ishte arrestuar si spiun serb. Djali i Kemajl Gashit dëgjoi ushtarët e UÇK-së duke rrahur atë në kazermën e Baranit. Kemajl Gashi u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në shtator 1998 në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.
- 88.1 Sanije Balaj jetonte në fshatin Strelle i Poshtëm. Më 11 ose 12 gusht 1998 ose rreth këtyre datave ajo shkoi me makinë drejt fshatit Rosujë në Pejë bashkë me dy ta afërm të saj. Në fshatin Baran një grup ushtarësh të UÇK-së të armatosur dhe me uniformë e ndaluan grupin dhe arrestuan Sanije Balajn si e dyshuar për bashkëpunim me serbët.

Pastaj Cufë Krasniqi dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së morën në pyetje Sanije Balajn. Pas marrjes në pyetje Idriz Gashi (i njohur edhe si “Galani”) dhe një ushtar tjetër i UÇK-së, Avni Krasniqi e çuan Sanije Balajn drejt shtabit kryesor të UÇK-së në Gllogjan për hetim të mëtejshëm. Gjatë rrugës ata e ndalën makinën në vendin e quajtur Lugu i Isufit. Idriz Balaj e çoi Sanije Balajn në pyllin e afërt dhe e pushkatoi. Më vonë Idriz Gashi dhe Avni Krasniqi u kthyen në pyll dhe e varrosën kufomën e saj. Pas disa ditësh **Idriz Balaj** dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së e zhvarrosën kufomën e saj. **Idriz Balaj** e mori kufomën dhe u largua me makinë në drejtim të Gllogjanit. Në shtator 1998, mbetja e kufomës së Sanije Balajt u gjet në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit.

88.2 Sejd Noci, shqiptar kosovar jetonte në fshatin Batushë në komunën e Gjakovës. Ai kërkohet prej UÇK-së. Në korrik 1998 një ushtar i UÇK-së shkoi në Koshare ku kishte bujtur Sejd Noci me qëllimin për ta arrestuar. Afërsisht në gusht 1998 ushtarët e UÇK-së çuan një të afërm të Sejd Nocit në shtabin e UÇK-së në Gllogjan ku ai u mor në pyetje prej Shkëlzen Haradinajt. Sejd Noci u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij u gjet në rrethinën e kanalit të Liqenit të Radoniqit në shtator 1998.

89. Gjatë burgimit të UÇK-së u vranë afërsisht pesë persona të tjerë dhe kufomat e tyre u hodhën në të njëjtin vend dhe në mënyrë të ngjashme me viktimat e identifikuar dhe përshkruara më lart. Ata mbeten të paidentifikuar.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 21:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, e ndëshkueshme sipas Nenit 5(a) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 22:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje, e njohur në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, e ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

### **PIKAT 23 dhe 24**

90. Më 19 maj 1998 ose rreth kësaj date, Ivan Zariqi(Ivan Zarić), serb, së bashku me dy romë/egjiptianë, Agron Berisha dhe Burim Bejta, u nisën prej fshatit të tyre Dolle dhe shkuan në mullirin e blojës në fshatin Grabanicë. Atje ata u arrestuan prej ushtarëve të UÇK-së të cilët i çuan në një shtëpi të braktisur dhe i rrahën keqazi. Pastaj ushtarët e UÇK-së i çuan në shtabin e Jabllanicës ku u mbajtën të burgosur.
91. Gjatë mbajtjes së tyre në objektin e burgimit të Jabllanicës dhe në praninë e **Ramush Haradinajt, Idriz Balaj** e gjymtoi Ivan Zariqin,

duke i prerë veshin dhe kërcënoi se do t'u bënte të njëjtën gjë Agron Berishës dhe Burim Bejtës.

92. Pas gjymtimit të Ivan Zariqit, **Lahi Brahimaj**, në praninë dhe dëgjimin e **Ramush Haradinajt** urdhëroi ekzekutimin e Ivan Zariqit, Agron Berishës dhe Burim Bejtës. Pastaj **Idriz Balaj** dhe një grup ushtarësh të UÇK-së të Shqiponjave të Zeza i larguan tre personat prej andej. Ata u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufomat e tyre nuk janë gjetur.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj**, **Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 23:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, Burgim, Tortura dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore(lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a), 5(e), 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 24:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor dhe Torturë të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 23 dhe Pikën 24;

**Idriz Balaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 23 dhe Pikën 24; dhe

**Lahi Brahimaj** urdhëroi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 23 dhe Pikën 24.

### **PIKAT 25 dhe 26**

93. Më 25 maj 1998 ose rreth kësaj date, ushtarët e UÇK-së rrënbyen dy romë/egjiptianë, Ukë Rexhepajn dhe dhëndrin e tij Nesret Alijaj në fshatin Grabanicë dhe i akuzuan si bashkëpunëtorë të serbëve. Ata u çuan në Shtabin e UÇK-së së Jabllanicës dhe në objektin e burgimit. Atje **Lahi Brahimaj** urdhëroi ekzekutimin e tyre. Ata u vranë gjatë burgimit nga UÇK-ja.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 25:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe**, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje dhe Veprime Të Tjera Çnjerëzore (burgim), të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 26:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe**,

**Lahi Brahimaj** urdhëroi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 25 dhe Pikën 26;

### **PIKAT 27 dhe 28**

94. Më 13 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Dëshmitari SST7/06, shqiptar kosovar katolik i konsideruar si bashkëpunëtor prej UÇK-së, u ndal nga ushtarët e UÇK-së në një postbllok në rrugën midis Klinës dhe Gjakovës. Ata kontrolluan automjetin dhe gjetën një armë zjarri. Ushtarët e UÇK-së e çuan në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Me të mbërritur atje, ai u rrah rëndë prej ushtarëve të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj, vëllai i **Lahi Brahimajt**.
95. Prej 13 qershorit 1998 deri afërsisht më 25 korrik 1998, Dëshmitari SST7/06 u mbajt në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë dhe në objektin e

burgimit. Gjatë burgimit të tij, Dëshmitari SST7/06 u rrah rregullisht prej **Lahi Brahimajt**, Nazmi Brahimajt dhe ushtarëve të tjerë të UÇK-së. Ai u rrah me shkopinj bejsbolli derisa thuajse humbi ndjenjat. Më 25 korrik 1998, ose rreth kësaj date, Dëshmitari SST7/06 u lirua prej shtabit të UÇK-së në Jabllanicë nga Nazmi Brahimaj.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 27:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Burgim, Torturë dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(e), 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 28:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Torturë, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Lahi Brahimaj** kreu ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 27 dhe Pikën 28;

### **PIKAT 29 dhe 30**

96. Më 13 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Nenad Remistar, oficer i policisë serbe u ndal prej ushtarëve të UÇK-së në një postbllok të UÇK-së në rrugën midis Klinës dhe Gjakovës. Ushtarët e UÇK-së e çuan në objektin e burgimit të UÇK-së në Jabllanicë. Me të mbërritur atje, ai u rrah rëndë me shkopinj bejsbolli prej ushtarëve të UÇK-së, ndër të cilët Nazmi Brahimaj, vëllai i **Lahi Brahimajt**.
97. Më 14 qershor 1998 ose rreth kësaj date, Nenad Remistari u nxor prej objektit të burgimit të UÇK-së në Jabllanicë. Ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Kufoma e tij nuk është gjetur.
98. Midis mesit të qershorit 1998 dhe fundit të korrikut 1998, një individ i panjohur i përkatësisë etnike bosnjake dhe tre individë të panjohur të përkatësisë etnike malazeze u sollën në objektin e burgimit të UÇK-së në Jabllanicë prej ushtarëve të UÇK-së. Këta individë u mbajtën për një periudhë afërsisht triditëshe gjatë së cilës ushtarët e UÇK-së i rrahën me shkopinj bejsbolli dhe u ngulën thika. Pastaj ata u nxorën prej objektit të burgimit nga ushtarë të UÇK-së.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 29:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, Burgim, Torturë dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a), 5(e), 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 30:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor dhe Torturë, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

### **PIKAT 31 dhe 32**

99. Më 10 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Pal Krasniqi, shqiptar kosovar katolik, shkoi në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë për t'iu bashkuar UÇK-së. Ai qëndroi disa ditë në shtabin e Jabllanicës, derisa u arrestua si spiun. Pastaj Pal Krasniqi u rrah rëndë me shkopinj bejsbolli, derisa u detyrua të bënte një pranim te rremë.
100. Pal Krasniqi u pa për herë të fundit i gjallë më 26 korrik 1998 ose rreth kësaj date në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë ku u mbajt. Ai u vra gjatë burgimit nga UÇK-ja. Në shtator 1998 mbetjet e kufomës së tij u gjetën në rrethinën e kanalit të Liqenin e Radoniqit.

101. Më 11 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Skënder Kuqi, shqiptar kosovar, u rrëmbye nga ushtarët e UÇK-së prej dyqanit të tij në Zahaq dhe u çua në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë ku ushtarë të UÇK-së e rrahën keqas me shkopinj dhe shufra metalike.
102. Më 16 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Skënder Kuqi, i pavetëdijshëm dhe i plagosur rëndë si pasojë e rrahjeve të pësuar gjatë burgimit prej UÇK-së, u transferua në objektin mjekësor të UÇK-së në Irzniq për mjekim, ku vdiq. Veshka e tij shihej prej një plaje të hapur si pasojë e rrahjeve. Ai u varros prej ushtarëve të UÇK-së në Jabllanicë. Më vonë kufoma e tij u zhvarros dhe iu dha familjes së tij në bazë të udhëzimeve të **Ramush Haradinajt**.
103. Më 13 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Dëshmitarit SST7/03, shqiptar kosovar i cili kishte refuzuar të luftonte për UÇK-në, iu kërkua prej **Lahi Brahimajt** ta shoqëronte deri në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Pasi erdhën në shtabin e Jabllanicës, Dëshmitari SST7/03 u burgos bashkë me dy njerëz të tjerë prej **Lahi Brahimajt**. Ushtarë të UÇK-së e rrahën SST7/03 derisa humbi ndjenjat.
104. Gjatë burgimit ushtarë të UÇK-së i morën në pyetje dhe i rrahën këta tre burra dhe i mbajtën të lidhur. Midis 13 korrikut 1998 dhe 16 korrikut 1998 Nazmi Brahimaj dhe Naser Brahimaj, i njohur si “Rusi” i rrahën në mënyrë të përsëritur dy të burgosurit e panjohur.

105. Më 16 korrik 1998 ose rreth kësaj date, Dëshmitari SST7/03 u çua në një zyrë ku ishin të pranishëm **Lahi Brahimaj, Idriz Balaj** dhe dy ushtarë të paidentifikuara të UÇK-së. **Lahi Brahimaj** i ftoi ushtaret e UÇK-së që ta rrihnin Dëshmitarin SST7/03, gjë që ato e bënë duke përdorur mjete. **Lahi Brahimaj** dhe **Idriz Balaj** e inkurajuan rrahjen. Gjatë rrahjes **Idriz Balaj** e akuzoi Dëshmitarin SST7/03, si spiun serb dhe e kërcënoi. **Lahi Brahimaj** e nxiti Dëshmitarin SST7/03 të vriste veten. Më vonë Dëshmitari SST7/03 u arratis.
106. Në fund të korrikut 1998 Dëshmitari SST7/03 u rrëmbye sërish nën tytën e armës në Jabllanicë prej **Lahi Brahimajt**. **Lahi Brahimaj** e çoi Dëshmitarin SST7/03 në shtëpinë e **Lahi Brahimajt** ku ai e rrahu dëshmitarin. Pastaj **Lahi Brahimaj** e çoi Dëshmitarin SST7/03 në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë, ku **Lahi Brahimaj** e mori në pyetje dhe e rrahu Dëshmitarin SST7/03 para se ta çonte në shtabin e UÇK-së në Gllogjan, ku Dëshmitari SST7/03 iu dorëzua një oficeri të policisë ushtarake të UÇK-së, i cili gjithashtu e rrahu dëshmitarin. Pastaj **Ramush Haradinaj** e liroi Dëshmitarin SST7/03 prej burgimit të UÇK-së.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 31:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (vrasje, burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe**, KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Vrasje, Burgim, Torturë dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(a), 5(e), 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 32:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Vrasje dhe Trajtim Mizor dhe Torturë, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 31 dhe Pikën 32;

**Idriz Balaj** kreu ose planifikoi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 31 dhe Pikën 32; dhe

**Lahi Brahimaj** kreu ose planifikoi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 31 dhe Pikën 32;

**PIKAT 33 dhe 34**

107. Më 23 maj 1998 ose rreth kësaj date, shqiptarët kosovarë, Naser Lika dhe Fadil Fazlija (Fazliu), të dy nga Grabanica, u rrëmbyen në fshatin Zhabel prej ushtarëve të UÇK-së, të dyshuar si tradhtarë për shkak se

thuhej që kishin përkrahur Lidhjen Demokratike të Kosovës (LDK). Ushtarët e UÇK-së i çuan në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë. Atje, **Lahi Brahimaj, Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe anëtarë të tjerë të UÇK-së i kërcënuan Naser Likën, Fadil Fazlinë (Fazliun) dhe afërsisht njëzet persona nga fshati Grabanicë, duke i informuar se ata nuk mund të jetonin në Kosovë nëqoftëse nuk e çlironin fshatin e tyre prej serbëve. UÇK-ja liroi Naser Likën dhe Fadil Fazlinë (Fazliun) pasi një anëtar i familjes ndërhyri dhe kërcënoi me “gjakmarrje”.

108. Në korrik 1998, **Lahi Brahimaj** dhe ushtarë të tjerë të UÇK-së e rrëmbyen përsëri Naser Likën në shtëpinë e tij në Grabanicë dhe e çuan në shtabin e UÇK-së në Jabllanicë, ku ai u soll para **Ramush Haradinajt** dhe **Idriz Balajt**. **Ramush Haradinaj** i tha **Lahi Brahimajt** të vazhdonte me “punën e tij”. Pastaj një ushtar i UÇK-së i njohur si ‘Bandashi’ e rrahu Naser Likën me shkop bejsbolli. **Ramush Haradinaj** urdhëroi në mënyrë të përsëritur ndërprerjen dhe rifillimin e rrahjes. **Idriz Balaj** e kërcënoi se do ta vriste Naser Likën. Gjatë rrahjes **Ramush Haradinaj** e pështyu në fytyrë Naser Likën. Ushtarët e UÇK-së e goditën në testikula kur ai ishte i shtrirë përtokë. Më pas Naser Lika u burgos për tri ditë në bodrumin e mbushur me ujë të ndërtesës së dytë të oborrit. Gjatë kësaj kohe ai u rrah përsëri rëndë. Më tej, Naser Lika u detyrua të punonte në kuzhinën e shtabit të UÇK-së. Pas rreth tri javësh, ai arriti të arratisej.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 33:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (burgim, tortura, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Burgim, Torturë dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(e), 5(f) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 34:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Torturë, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Ramush Haradinaj** urdhëroi, nxiti ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 33 dhe Pikën 34;

**Idriz Balaj** kreu ose planifikoi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 33 dhe Pikën 34; dhe

**Lahi Brahimaj** kreu ose planifikoi ose ndihmoi dhe inkurajoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 33 dhe Pikën 34;

**PIKAT 35, 36 dhe 37**

109. Dëshmitari SST7/01 dhe Dëshmitarja SST7/02 jetonin në fshatin Irzniq. Në fillim të vitit 1998, ushtarët e UÇK-së hynë në fshatin Irzniq dhe formuan një shtab në fshat, në një ndërtesë të bashkëngjitur shkollës së fshatit. Në këtë shtab u vendosën **Idriz Balaj** dhe anëtarët e njësisë së tij, “Shqiponjat e Zeza”. **Ramush Haradinaj**, si komandant i rajonit të Dukagjnit, vinte rregullisht në fshatin Irzniq dhe i urdhëronte fshatarët ta mbronin rajonin kundër serbëve dhe të hapnin llogore në vendet që kishte zgjedhur ai.
110. Në prill 1998, ushtarë të UÇK-së urdhëruan Dëshmitarin SST7/01 të merrte pjesë në hapjen e llogoreve me ushtarë të UÇK-së. Dëshmitari SST7/01 u paralajmërua se nëqoftëse nuk merrte pjesë ai do të vritej. Në disa raste Dëshmitari SST7/01 u detyrua të punonte për periudha të gjata kohore pa ngrënë e pa pirë. Ai nuk u pagua për këtë punë e cila zgjati afërsisht tre muaj. Pasj kësaj kohe Dëshmitari SST7/01 u detyrua prej UÇK-së të bënte punë të papaguar në bujqësi.
111. Disa herë gjatë vitit 1998, **Idriz Balaj** e përdori Dëshmitarin SST7/01 si “mburojë njerëzore” në Zonën Operative të Dukagjinit duke e detyruar të ecte para **Idriz Balajt** dhe ushtarëve të tij të UÇK-së me qëllim që të tërhiqte zjarrin e armikut mbi vehte.
112. Në fund të korrikut ose në fillim të gushtit 1998, **Idriz Balaj** dhe katër ushtarë të UÇK-së, të maskuar dhe me uniforma, detyruan Dëshmitarin SST7/01 dhe Dëshmitaren SST7/02 të ecnin deri në

shtabin e UÇK-së në Irzniq. **Idriz Balaj** e çoi Dëshmitaren SST7/02 në ndërtesë për ta marrë në pyetje për pjesëmarrjen ose bashkëpunimin e saj me forcat policore dhe ushtarake serbe. Pasi e kishte marrë në pyetje, **Idriz Balaj** urdhëroi një ushtar tjetër të UÇK-së që ishte në dhomë t'i linte vetëm. Pastaj **Idriz Balaj** e shtyu atë në një shtrat, dhe e përdhunoi në mënyrë të përsëritur.

113. Familja e Dëshmitares SST7/02 ia raportoi përdhunimin autoriteteve lokale të UÇK-së. **Idriz Balaj** u tha ushtarëve të UÇK-së se ai ishte urdhëruar për kryerjen e përdhunimit. Kundër tij nuk u mor asnjë masë.
114. Dëshmitari SST7/01 u çua në ndërtesën e shtabit. **Idriz Balaj** i vuri thikën në fyt Dëshmitarit SST7/01 dhe e kërcënoi se do t'ia priste kokën për shkak të përkatësisë së tij etnike. Pastaj **Idriz Balaj** i tha atij se të gjithë anëtarët e grupit të tij etnik duhej të largoheshin nga Kosova. Më tej Dëshmitari SST7/01 u lidh pas kornizës metalike të një shtrati. Në vijim **Idriz Balaj** dhe ushtarë të UÇK-së e rrahën atë.

Me këto veprime dhe mosveprime **Ramush Haradinaj, Idriz Balaj** dhe **Lahi Brahimaj** kryen si pjesëmarrës të NPK-së përkufizuar në paragrafët e mësipërm 26 dhe 27 krimet e mëposhtme;

**Pika 35:** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Përndjekje (burgim, tortura, përdhunim, veprime të tjera çnjerëzore, rrëmbim, punë e detyruar), e ndëshkueshme sipas Nenit 5(h) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Ndryshe,** KRIM KUNDËR NJERËZIMIT, Burgim, Torturë, Përdhunim dhe Veprime të Tjera Çnjerëzore (punë e detyruar, lëndime të rënda fizike dhe mendore) të ndëshkueshme sipas Neneve 5(e), 5(f), 5(g) dhe 5(i) dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 36:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Përdhunim, i ndëshkueshëm sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit;

**Pika 37:** SHKELJE E LIGJEVE OSE ZAKONEVE TË LUFTËS, Trajtim Mizor dhe Torturë, të njohura në Nenin e Përbashkët 3(1)(a) të Konventave të Gjenevës të vitit 1949, të ndëshkueshme sipas Nenit 3 dhe Nenit 7(1) të Statutit të Tribunalit.

**Ndryshe,**

**Idriz Balaj** kreu ose planifikoi kryerjen e krimeve të përshkruara në Pikën 36 dhe Pikën 37.

---

Carla Del Ponte  
Prokurore

Më datën 16 tetor 2007  
Në Hagë  
Holandë